



Pranimur / Dorezuar Priniljeno / Prodato Received / Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ / Mjesta Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	8600/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1007/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1007/2022 të datës 15.11.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë banimi \_\_\_\_\_, kundër Vendimit me Nr.111/01-29429/22 të datës 25.10.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Dragashit, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1007/2022 e datës 15.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet procedura e pranimit sipas Konkursit me numër reference RN00009377 i shpallur më datë 05.07.2022 për grup pozitash *Specialist i Inxhinierisë të Ndërtimit-Zyrtar për Ndërtimtari* në Komunën e Dragashit.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Dragashit për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të njëjtë.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ kandidat për pranim në Shërbimin Civil, me datë 15.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7091/2022 të regjistruar në shenjen A.nr.1007/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.111/01-29429/22 të datës 25.10.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Dragashit, për shkak të shkeljeve procedurale-ligjore dhe vlerësim jo meritore.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Dragashit, ndërsa më datë 25.11.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritorë administroi këto prova:*

Ankesën e ankueses me Nr.Prot:7091 të datës 15.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00009377 të datës 05.07.2022 për pozitën Specialist i Inxhinierisë së Ndërtimit; Vendimin me Nr.111/01-11741/22 të datës 30.08.2022; Njoftimin për kandidatin për testin me shkrim për pozitën "Specialist i Inxhinierisë së Ndërtimit"; Emalin e datës 21.09.2022 të SIMBNJ-së drejtuar ankuesit; Emalin e datës 30.09.2022 të SIMBNJ-së drejtuar ankuesit; Emalin e datës 30.09.2022 të drejtuar Emalin e datës 14.10.2022 të SIMBNJ-se drejtuar ankuesit; Njoftimin e datës 13.10.2022 të Burimeve Njerëzore lidhur me përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe shpalljen e rezultatit me fitues për pozitën " specialist i Inxhinierisë së Ndërtimit"; Njoftimin me numër të protokollit 111/01-29354 të datës 25.10.2022; Vendimin me numër të protokollit 111/01-29429/22 të datës 24.10.2022; Kërkesën me numër të protokollit 03/111/01-28596 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Komunën e Dragashit; Ankesën e datës 27.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Administratën Tatimore të Kosovës -Regjioni i Prizrenit, Inspektoratin e ATK-së; Diplomën universitare me Nr.159 të datës 26.03.2004; Shtojcën e diplomës me numër reference; 3038/1 të datës 01.07.2016; Referencën e datës 29.08.2013; Referencën (pa numër dhe datë) lidhur me përvojën e punës; Referencën e datës 26.12.2016 lidhur me përvojën e punës në "KAG ASPHALT COMPANY" SHPK; Pasqyrën e llogarisë (Trustin) për periudhën kohore 16.08.2005 deri me datën 08.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7223/2022 të datës 18.11.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 7408/2022 të datës 25.11.2022; Vendimin e Komisionit për Pranim të datës 12.09.2022 në Komunën e Dragashit; Vendimin me Nr.111/01-11741/22 të datës 30.08.2022; Dosjen e kandidatit të përzgjedhur; Aplikacionin e datës 02.08.2022; Diplomën me Nr.2298 të datës 02.04.2021; Vërtetimin e kopjes së dokumentit lidhur me noterizimin e diplomës nën shenjen LRP.NR.3514/2022; Certifikatën e datës 11.04.2017; Referencën e datës 01.08.2022 lidhur me përvojën e punës; Pasqyrën e llogarisë bankare për periudhën kohore 02.08.2022 deri me datën 08.08.2022; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Vërtetimin e datës 25.07.2022; Dosjen e ankuesit; Aplikacionin e datës 11.08.2022; Diplomën universitare me Nr.159 të datës 26.03.2004; Pasqyrën e llogarisë (Trustin) për periudhën 16.08.2005 deri me datën 08.08.2022; Referencën (pa datë dhe numër) lidhur me përvojën e punës; Referencën (pa datë dhe numër) lidhur me përvojën e punës; Referencën e datës 26.12.2016 lidhur me përvojën e punës; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve nuk është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Njoftimin e kandidateve për testin me shkrim për pozitën Specialist i Inxhinierisë së Ndërtimit; Emalin me numër të protokollit 8243/2022 të datës 20.12.2022 të M.Emini drejtuar Këshillit; Pyetjet nga intervista me gojë të datës 05.10.2022 të kandidatit ; Pyetjet nga intervista me gojë të datës 05.10.2022 të kandidatit Renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën Specialist i Inxhinierisë së Ndërtimit; Shkresën e marr nga SIMBNJ- lidhur me përfundimin e vlerësimit të aplikantëve.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Dragashit më datë 05.07.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00009377 për grup pozitash "Specialist i Inxhinierisë të Ndërtimit-Zyrtar për Ndërtimtari" klasa profesional 2, i hapur për aplikim nga data 26.07.2022 deri me 12.08.2022.

Ankuesi si kandidat për pozitën përkatëse të punës është përfshirë në listën e ngushtë dhe së i njëjti ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të kësaj procedure pranimit. Me datë 14.10.2022, ankuesi përmes sistemit elektronik- SIMBN, njoftohet nga njësia përgjegjëse lidhur me publikimin e rezultateve përfundimtar, rrjedhimisht sipas njoftimit të datës 13.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore kandidati . është shpallur kandidat fitues me gjithsej 90.4 pikë.

Kundër këtij njoftimi ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni i Pranimit me Vendimin me numër protokolli 111/01-29429/22 të datës 25.10.2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 15.10.2022.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokolli 111/01-29429/22 të datës 25.10.2022 të Komisionit të Pranimit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Konkursi me numër reference RN00009377 është përcjell me shkelje procedurale dhe ligjore dhe vlerësim jo meritator të ankuesit, duke theksuar faktin se ka pas tejkallim të afatit kohor për kryerjen e verifikimit paraprak, kandidati i përzgjedhur nuk e plotëson kriterin e përvojës se punës sipas konkursit, Komisioni i Pranimit nuk ka bërë vlerësim meritator pasi që tek jetëshkrimi ankuesin e ka vlerësuar vetëm me një pikë me tepër se kandidatin e përzgjedhur, ankuesi nuk është njoftuar me rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit së janë tejkalluar afatet ligjore të fazë së verifikimit paraprak, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 15 të kësaj rregullore ku është përcaktuar se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4. Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve, dhe rrjedhimisht konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me tejkallimin e afatit ligjor për publikimin e listës së ngushtë është i drejtë dhe i bazuar, ngase Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur së data e fundit për aplikim në Konkursin me numër reference RN00009377, ka qenë data 12.08.2022, ndërsa vendimi lidhur me kandidatët që kanë plotësuar kriteret e shpallura sipas konkursit është nxjerrë më datë 30.08.2022, rrjedhimisht lista e ngushtë është shpallur pas 18 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit, veprim ky në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 4 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Përkitazi me pretendimin ankimore të ankuesit së kandidati i përzgjedhur nuk i plotëson kriteret e konkursit sa i përket përvojës së punës, Kolegji i Këshillit bazuar në provat e lëndës gjegjësisht duke ju referuar Konkursit me numër reference RN00009377 të datës 05.07.2022 për grup pozitash "Specialist i Inxhinierisë të Ndërtimit-Zyrtar për Ndërtimtari" në Komunën e Dragashit ka gjetur së kritere formale për këtë grup pozitash janë përcaktuar: "Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare Fakultetin e Ndërtimtarisë me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv. Përvoja e punës së kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë". Ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidatit fitues, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti sipas Diplomës me Nr.2298, ka përfunduar studimet themelore me datë 11.03.2021 në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Programin Konstruktiv pranë Universitetit të Prishtinës, ndërsa lidhur me përvojën e punës posedon Referencën e datës 01.08.2022 të lëshuar nga biznesi "Edmond Qollaku" BI, për periudhën 01.05.2020 - 01.06.2022, duke mos përmbajtur të dhëna lidhur me titullin e vendit të punës, ndërsa sipas Pasqyrës së Trust-it, rezulton së kandidati fitues gjatë afatit të aplikimit përkatësisht me datë 02.08.2022 ka deklaruar kontributet pensionale për periudhën dy vjeçare dhe atë nga qershori 2020 deri maj 2022.

Për sa me sipër, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, kandidati fitues nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës në fushën përkatëse, dy (2) vjeçare, siç kërkohet në konkurs, ngase përvojë pune në fushën përkatëse njihet përvoja e fituar pas diplomimit në fushën e përcaktuara në konkurs (Fakulteti i Ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv), ndërsa i njëjti ka diplomuar me datë 11.03.2021, kurse data e fundit për aplikim në konkursin përkatës të punës ka qenë data 12.08.2022, nga rrjedh se kandidati i përzgjedhur nuk i ka dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit. Konstatimi i Kolegjit lidhur me njohjen e përvojës së punës profesionale vetëm pas diplomimit është i bazuar edhe në Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit se kandidati fitues nuk e plotëson kriterin e përvojës së punës, është i drejtë dhe i bazuar.

Kolegji i Këshillit po ashtu thekson faktin se kandidati i përzgjedhur lidhur me përvojën e punës ekzistuese nuk ka sjellë dëshmi valide, ngase referencat lidhur me përvojën e punës në sektorin privat nuk janë dëshmi të mjaftueshme dhe të vlefshme për të provuar faktin e përvojës së punës pasi që të njëjtat nuk janë të shoqëruara me vërtetim nga organet përgjegjëse gjegjësisht Administrata Tatimore dhe Fondi i Kursimeve Pensionale.

Kolegji i Këshillit po ashtu nga analizimi i veprimeve të ndërmarra në këtë procedurë të rekrutimit, sipas pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar së ankuesi nuk ishte njoftuar individualisht lidhur me vlerësimin përfundimtar ashtu siç parashihet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 25 paragrafi 4 ku përcaktohet se: ... 4. Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit., andaj mbi këtë bazë rrjedhë së edhe ky pretendim ankimor i ankuesit është i drejtë dhe i ligjshëm.

Andaj, pas konstatimit të shkeljeve procedurale dhe të ligjit material, Kolegji i Këshillit konstaton së kjo procedure e rekrutimit është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që duke u bazuar në



nenin 18 paragrafin 1 nënparagarfi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1007/2022

Elakron Gashi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.